



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:160501
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05550225

C. nr. 220/2016

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore, të paditësit A. B. nga, dhe A.R. nga, të cilët i përfaqëson me autorizim Enver Ajvazi, avokat nga Kamenica, kundër të paditurve R. R., N. R., S.R., S. B. nga, S. R., Il. R. nga, I.R., H. R., G. R., H. H. nga, E. L., nga, si dhe S.B. nga me objekt kontesti për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 500.00 euro, pas mbajtjes së seancës përgaditore, më datën 05.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes së të paditurit R. R. nga

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit të të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

paditësit A. B. nga, tani me vendbanim në nga dhe A. R. nga, përmes të autorizuarit të tyre avokatit Enver Ajvazi nga Kamenica, më datën 09.09.2016, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi kundër të paditurve R.R., N. R., S. R., S. B. nga, S. R., I. R. nga, I. R., H. R., G. R., H. H. nga, E.L., nga, si dhe S. B. nga, për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 500.00 euro.

Në seancën përgaditore të mbajtur më datën 05.04.2024, i autorizuari i paditësve, avokati Enver Ajvazi nga Kamenica, e ka informuar gjykatën se sipas informatave të cilat i njëjti i ka marrë nga familjarët e paditësve nga fakti se të njëjtin e kanë njohur personalisht, të paditurin R. R. nga, ka vdekur, e duke e pasur parasysh këtë fakt, i njëjti i ka propozuar gjykatës që procedura në këtë çështje juridike kontestimore të ndërpritet sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, deri sa paditësit ti sigurojnë trashëgimtarët e të paditurit R. R., dhe ta rregullojnë legjitimitetin real pasiv të palëve në procedurë.

Të paditurit nuk kanë prezentuar në seancën përgaditore të datës 05.04.2024, ngase disa prej tyre nuk kanë mund të gjinden në adresën e cekur si në padi, ndërsa disa të tjerë nuk e kanë arsyetuar mungesën e tyre.

Po ashtu, në bazë të fletëkthesës e cila gjindet në shkresat e lëndës, gjykata e ka konstatuar se paditësi R. R. nga, ka vdekur.

Andaj, duke i marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (a), të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm – Dvizioni Civil

C. nr. 220/2016, i datës 05.04.2024

G j y q t a r i

Artan Abazi d,y

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.